



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.N. "R&Rukolli" Sh.p.k.  
Pronar: Rustem RRUKOLLI  
OSHP TV Skenderaj  
OSHP31  
Rr/18 Qershori  
Skenderaj

Ref: 1404/532/KPM/ni

**VENDIM**

*për shpalljen e pavlefshme të licencës së OSHP TV SKENDERAJ*

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. OSHP TV SKENDERAJ është një ofrues i shërbimeve programore i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për të ofruar programe përmes rrjetit kabllor, në pajtim me rregulloren CIMC 2007/04. OSHP TV SKENDERAJ është pajisur me licencë të KPM-së më 21 prill 2010.
3. OSHP TV SKENDERAJ edhe pse është licencuar nga KPM, për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore me seli në Skenderaj, asnjëherë nuk ka filluar me transmetim të programit.
4. Më 24 dhjetor 2013, KPM është njoftuar zyrtarisht me shkrim nga OSHP TV SKENDERAJ, se heq dorë nga licenca për ofrimin e shërbimeve programore.
5. Përmes të njëjtës shkresë, i licencuari ka njoftuar se, për arsye se nuk janë të interesuar për funksionalizimin e OSHP TV SKENDERAJ, heqë dorë nga licenca e KPM-së.

### Arsyetimi


6. Me njoftimin e OSHP TV SKENDERAJ që në mënyrë vullnetare heqë dorë nga licenca e ofruesit të shërbimeve programore, Komisioni, merr Vendim për shpallje të pavlefshme të licencës të OSHP TV SKENDERAJ.

### Vendim

7. Komisioni, merr këtë Vendim përmes të cilit shpallë të pavlefshme Licencën e OSHP TV SKENDERAJ për ofrimin e shërbimeve programore, që nga data e njoftimit të përfaqësuesit të OSHP TV SKENDERAJ

### Lëshimi i Vendimit

8. Këtë Vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



15.05.2014  
datë